



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E AERODROMEVE

Nr. 2150 prot.

Tiranë, më 11.9.2024

VENDIM

Nr. 100, datë 11.9.2024

PËR

PËR PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E MJETEVE TË PËRPUTHSHMËRISË
(AMC) DHE MATERIALEVE UDHËZUESE (GM) TË EASA PËR PËRDORIM PËR
ZBATIMIN E URDHRI TË MINISTRIT TË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË NR. 170, DATË 13.09.2022

Në mbështetje të Nenit 14, pika (ë), të Ligjit Nr. 53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil", në zbatim të pikës ADR.AR.A.015, të Aneksit 2, të Urdhrit të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S A:

1. Pranimin e AMC dhe GM të EASA, lëshimi 1, amendimi 7 dhe 8 për zbatimin e Rregullores së Komisionit (BE) NR 139/2014 të 12 Shkurt 2014.
2. Për të siguruar përputhshmërinë me Urdhrin e Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjisë Nr. 170, datë 13.09.2022, AAC dhe operatori i aerodromit do të përdorin AMC, GM të EASA të pranuar me këtë vendim dhe të publikuara nga EASA, ED Decision 2023/003/R dhe ED Decision 2022/016/R.
3. Këto materiale do të përdoren në gjuhën angleze sipas variantit të konsoliduar të publikuar nga EASA në linkun <https://www.easa.europa.eu/en/document-library/agency-decisions/ed-decision>.
4. Ngarkohet Drejtoria e Aerodromeve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Drejtoria e Aerodromeve të marrë masa për njoftimin dhe publikimin për aplikantët apo operatorët ekzistues, të pranimit të AMC, GM të mësipërme.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

